



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" SH.A
 LOKALNA JAVNIM PREDUZEĆIMA "AMBIENTI" A.D
 LOCAL PUBLIC ENTERPRISES "AMBIENTI" J.S.C
 Ferizaj - Kosovë





Datë: 31.10.2023

Nr. 218/23

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
 "Ambienti" SH.A. FERIZAJ
 Nr. 218/23
 Datë: 31.10.2023

PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2024

**Miratohet Plani i Biznesit me 31.10.2023 i NPL "Ambienti" Sh.A.
 Ferizaj për vitin 2024**

	Propozoj	Aprovoj
Pozita:	Kryeshef Ekzekutiv	Bordi i Drejtorëve
Emri dhe Mbiemri	Arton Gavazi	Genç Retkoceri
Nënshkrimi		
Vula		

P Ë R M B A J T J A

Hyrje	3
Misioni	4
Vizioni	5
Organizimi dhe struktura organizative	5
Sektorët e ndërmarrjes	6
Zyrët e ndërmarrjes	6
Organogrami	7
Korniza ligjore	8
Fushëveprimtaria	8
Objektivat	9
Paraqitja grafike e të hyrave	10
SWOT analiza	11
Problematika e përgjithshme	12
Metodologjia	13
Trajtimi i hapësirave	13
Planifikimi operativ dhe planifikimi financiar	14
Planifikimi i burimeve njerëzore (personeli)	14
Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	15
Planifikimi financiar	16
Ndryshimi në ekuitet	18
Investimet kapitale	19
Shërbimet për parkingje	20
Përmbledhja e shpenzimeve investive	20
Qëndrueshmëria	21

H Y R J E

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është ndërmarrje e cila kryen shërbime të ndryshme, në shërbim të interesit të përgjithshëm qytetarë, si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra nëpër gjithë territorin e Komunës së Ferizajt. Ndërmarrja kryesisht menaxhon me parkingjet publike në Komunën e Ferizajt, menaxhimin e tregjeve (tregun e gjelbërt, tregu në dardani, dhe tregun e kafshëve), mirëmbajtjen e oborreve të zyrave të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare, ambulancat, parqet, kopshtet e fëmijëve, bibliotekat, fushat sportive, hapësirat e gjelbërta publike, oborret e banesave të vjetra kolektive, prerja e drunjëve, mirëmbajtja e trotuarëve dhe punë të tjera të cilat mund të kontraktohen nga Komuna e Ferizajt.

Kuvendi i Komunës së Ferizajt me datën 27.05.2014 ka marr Vendim me Nr.86, me të cilin vendim u bë themelimi i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, ku më pas me datën 23.03.2016 Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovon këtë vendim dhe nxjerr Vendim me numër protokolli 09/81 për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është Shoqëri Aksionare, në të cilën Komuna e Ferizajt është në pronësi 100% të aksioneve në N.P.L "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji nr.03/L-087) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin (Ligji nr.04/L-111) dhe (Ligjin nr.03/L-009), Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj është Ndërmarrje Publike Lokale e organizuar si Shoqëri Aksionare, e cila sipas ligjit i përgjigjet dhe e i raporton Kuvendit të Komunës të Ferizajt dhe Komunës së Ferizajt, përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve i Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Plani i Biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes. Ky plan është përpiluar duke pasur parasysh dhe duke u bazuar në informatat e vitit 2023 dhe trendet zhvillimore ndër vite dhe kërkesat e sektorëve, marrëveshjet e ndryshme, i cili ofron planifikim më të detajuar lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për vitin 2024.

Në këtë plan përshkruhet afarizmi vjetor i bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes, me qëllim të ofrimit të të gjitha informatave të nevojshme, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve në ndërmarrje. Plani i biznesit për vitin 2024 është i zbërthyer në mënyrë të detajuar, për secilin zë. Pjesa strategjike e këtij plani vazhdimisht monitorohet, rishqyrtohet dhe sipas nevojës mund të ndryshohet nga Bordi i Drejtorëve, nëse ka pasur lëvizje në aspektin e lidhjes të

ndonjë kontrate, apo ndonjë donacioni eventual, apo edhe përfitimit të ndonjë projekti qoftë vendor apo ndërkombëtar, apo ka ndodhur gjëra të pa parashikueshme të fuqisë madhore.

Rëndësia e këtij plani është se i njëjti do të shërbej për Bordin e Drejtorëve të Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj dhe Menaxhmentin e Ndërmarrjes Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, si dokument për zhvillimin dhe vendosjen e prioriteteve të investimeve në të ardhmen, është shumë i rëndësishëm për të arritur sukses, i cili na ndihmon të përcaktohem në qëllimet, strategjitë dhe hapat e mëtejshëm, me qëllim që të kemi suksese dhe rezultate.

Misioni

Misioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është t'i mbulojë dhe të ju shërbej me shërbime të cilat bien në domenin e ndërmarrjes të gjithë qytetarët e Komunës së Ferizajt, pa dallim race, religjioni apo kombësie, të shërbejë dhe të kontribuojë në mirëqenien e qytetarëve dhe komunitetit të tyre, kjo mund të përfshijë organizimin e fushatave për ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e infrastrukturës publike dhe promovimin e vlerave të rëndësishme për shoqërinë në aspektin e të gjelbërtës (Green Agenda).

NPL "Ambienti" Sh.A. Ferizaj mision i saj është që të kujdeset për parqet dhe hapësirat e gjelbërta në fshat dhe qytet, duke siguruar mjedis të pastër dhe tërheqës për të gjithë qytetarët, kjo përfshinë mirëmbajtjen dhe ruajtjen e ambientit të përbashkët, me qëllim për të krijuar një ambient të qetë dhe të relaksuar për të gjithë përdoruesit.

Mision tjetër i ndërmarrjes është që të sigurohem që ndërmarrja në aspektin financiar dhe operativ të jetë e vetë-qëndrueshme dhe në aspektin kohor të jetë afatgjatë, që të mund të sigurojë menaxhimin me standart të lartë të hapësirave publike dhe parkingjeve publike në pajtim me standardet ndërkombëtare, ku duke përmbushur këtë mision do të jetë e mundur sigurimi i vetëqëndrueshmërisë së ndërmarrjes në aspektin afatgjatë.

Qasja në afarizmin e ndërmarrjes do të jetë transparenca dhe llogaridhënia e bazuar në dispozitat pozitive ligjore. Transparenca dhe llogaridhënia do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit: 1. Qytetarët, 2. Ministritë e Linjës, 3. Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "Ambienti" Sh.A. Ferizaj i Komunës së Ferizaj, 4. Bordin e Drejtorëve,

Vizioni

Vizioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj është të ndihmojë në krijimin e një qytetit (mjedis) të qendrueshëm të pastër, të zhvilluar dhe të përmirësuar për të gjithë qytetarët, ky vizion përfshinë zhvillimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e mirëqenies së përgjithshme në komunitet, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta publike, krijimin e hapësirave të gjelbërta publike, promovimin e energjisë të pastër dhe përmirësimin e shërbimeve në vazhdimësi si në menaxhimin e hapësirave të gjelbërta publike, ashtu edhe menaxhimin e parkingjeve publike dhe tregjeve.

Të zgjeroj shërbimet, të sigurojë një kualitet të shërbimeve në pajtim me normat dhe standardet e BE-së. Ruajtja dhe mirëmbajtja e aseteve të ndërmarrjes, si dhe rritja e investimeve kapitale, për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj klientëve ekzistues dhe atyre potencial në të ardhmen. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi kryesor i ndërmarrjes.

Përmes aktiviteteve të rëndomta operative dhe financiare në të ardhmën do të krijohen kushte të favorshme, për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake dhe nga investitorët tjerë. Përafrimi i përmbushjes së një vizioni të tillë, do të krijojë parakushte më të mira për bashkëfinancim dhe investime nga institucionet tjera financiare.

Organizimi dhe struktura organizative e ndërmarrjes

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, mbikqyret nga Bordi i Drejtorëve. Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe organogramit të ndërmarrjes menaxhmenti i lartë i ndërmarrjes përbëhet nga pozitat si në vijim: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Sekretari i Ndërmarrjes, Zyrtari i Lartë Financiar dhe Zyrtari për Auditim të Brendshëm.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj organizohet në sektorë dhe zyre, të cilët për punën e tyre i përgjigjen drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, përbëhet prej 5 sektorëve dhe 4 zyreve, dhe pjesa tjetër e mbetur inkorporohet në këto sektorë apo zyre.


Sektorët e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:

1. Sektori i Administratës;
2. Sektori i Financave dhe Kontabilitet;
3. Sektori i Operativës;
4. Sektori Inkasimit, dhe
5. Sektori i Kontrollës.

Zyret e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:

1. Zyra e Prokurimit;
2. Zyra Ligjore;
3. Zyra e Burimeve Njerëzore;
4. Zyra për Marketing, dhe
5. Zyra për Klientë.

Në organogramin e mëposhtëm është paraqitur struktura organizative e ndërmarrjes



Antarës të Bureve të Përgjendjes NPL "Ambienti" Sh.A

1. Gëlle Rrahoveci-Kryeshmëri i Këshillit
2. Selama Rrahmja-Antarës i Bureve
3. Fatmir Arifi-Antarës i Bureve
4. Fatmir Xhokri-Antarës i Bureve
5. Arben Gurraji-Kryeshmëri i Përgjendjes

Gëlle Rrahoveci _____

Korniza ligjore

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj veprimtarinë operative dhe financiare do t'a organizojë dhe do ti përmbushë detyrimet, duke marrë për bazë zbatimin e dispozitave pozitive ligjore dhe akteve nënligjore:

1. Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe plotësim ndryshimet e ligjit;
2. Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
1. Ligji Nr. 03/L – 025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
2. Ligji Nr. 03/L- 048 për Menaxhimin e Financave Publike;
3. Ligji Nr. 04/L-116 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi;
4. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
5. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
6. Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
7. Statuti i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj;
8. Rregullorja 02/2013 për Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale 02/2013;
9. Vendimi 01.Nr.86 i datës 27.05.2014 i Kuvendit të Komunës të Ferizajt;
10. Vendimi Nr. 09/81 i datës 23.03.2016 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Fushëveprimtaria

- Menaxhimin e të gjitha vendparkingjeve të cilat janë në pronësi të Komunës së Ferizajt;
- Menaxhon hapësirat e gjelbëruara (Parkun "Liria", parkun në qendër të qytetit, parkun e pishave në Rahovicë dhe parqet e tjera të qytetit), si dhe parqet e rregulluara në territorin e Komunës së Ferizajt;
- Mirëmbajtjen e vendparkingjeve;
- Dhënien e lejeve dhe hyrjen e automjeteve në vende të siguruar për parking;
- Kujdeset dhe mirëmban sheshin e qytetit dhe sheshet të tjera në qytet;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e përmendoreve brenda dhe jashtë qytetit;
- Mirëmban varrezat e dëshmorëve;
- Mbjelljen e luleve dhe drunjëve dekorues;


- Mirëmbajtjen dhe krasitjen e drunjëve në qytet;
- Heqjen e borës nëpër trotuare;
- Mirëmbajtja e objekteve publike banesore kolektive;
- Mirëmbajtja higjenike e objekteve publike;
- Menaxhimin e tregjeve (tregun e gjelbërt, tregun e kafshëve, tregun në Dardani);
- Krijimi i hapësirave të gjelbërta etj.

Objektivat

Objektivat kryesore të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj për menaxhimin e hapësirave publike janë:

- Përmirësimi i standardeve të shërbimeve, me fokus kryesor në përmirësimin e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve;
- Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit në lidhje me vullnetin për të përmirësuar shërbimet, nëpërmjet zbatimit të funksionit të shërbimit për qytetarët më me efektivitet dhe cilësi;
- Përmirësimi i performancës dhe arritja e qëndrueshmërisë financiare gjatë operimit të saj;
- Zgjerimi i veprimtarisë e cila do të siguronte rritjen e të hyrave gjatë viteve të ardhshme;
- Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Qëndrueshmëria financiare;
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative;
- Rritja e shkallës së faturimit dhe inkasimit;
- Zgjerimi i shërbimeve në tërë territorin e Komunës së Ferizajt;
- Thithja e fondeve dhe donacioneve nga organizatat e huaja dhe ato vendore;
- Menaxhimi i oborreve të shkollave dhe banesave publike kolektive për vendparkingje;
- Mirëmbajtja higjenike e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të banesave publike kolektive.

Grafikoni 1- Paraqitja grafike e pjesëmarrjes së të hyrave sipas veprimtarive për vitin 2024



Grafikoni: 1.0

Rritja e të hyrave nga marrëveshja me Komunën e Ferizajt do të përmirësonte gjendjen financiare të ndërmarrjes, për shtimin e kapaciteteve teknike të makinerive të nevojshme, të cilat mund të jenë më ekologjike dhe më inovative, për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytetet dhe fshatra dhe lokacionet e tjera.

Swot Analiza**Përparësit:**

Nr	Emërtimi
1.	Marrja e tenderëve
2.	Stafi i kualifikuar
3.	Çmimi më i lirë se konkurenca
4.	Shërbime profesionale
5.	Pagesat e përfunduara të gjitha
6.	Tregu stabil i shërbimeve që ofron ndërmarrja

Mundësit:

Nr	Emërtimi
1.	Ambient të pastër
2.	Negocimi me klientelën
3.	Kampanja sensibilizuese (Ta pastrojmë Kosovën etj).

Mangësitë:

Nr	Emërtimi
1.	Mungesa e automjeteve dhe mjeteve të punës
2.	Mungesa e kamerave nëpër gjitha vendparkingjet
3.	Mungesa e digjitalizimit të parkingjeve

Rrëziqet:

Nr	Emërtimi
1.	Rrëziqet e ndryshimeve klimatike
2.	Informaliteti dhe konkurrenca jo lejale
3.	Shfaqja e ndonjë pandemie apo fatkeqësie të tjera natyrore
4.	Mos arkëtimi i shërbimeve ndaj klientëve me kohë dhe borxhet e këqija

Problematika e përgjithëshme

Menaxhimi i të gjitha hapësirave, zonave, nënkalimeve, përmendoreve, varrezave etj, mbetet një çështje prioritare për komunat në Kosovë. Sipërfaqja e këtyre hapësirave është duke u rritur, ndërsa infrastruktura ekzistuese për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre nuk është adekuate dhe nuk përputhet me standardet e BE-së. Prandaj duhet të gjinden zgjidhje të përshtatshme për problemet ekzistuese. Vonesat në gjetjen e zgjidhjeve për të gjitha llojet e hapësirave të cekura më lartë kanë rezultuar me situatën aktuale, e cila lë shumë për të dëshiruar.

Vështirësitë në sektorin e mirëmbajtjes së këtyre hapësirave në komunën tonë janë të shumfishta, si:

- Njohuritë e pamjaftueshme në lidhje me praktikat e menaxhimit dhe trendet që aktualisht zbatohen në BE;
- Edukimi i pamjaftueshëm i publikut dhe i të punësuarve në kompanitë që merren parçialisht me menaxhimin e atyre hapësirave;
- Mungesa e organizimit dhe e sistemit të mirë administruar;
- Zbatimi i pjesëshëm i legjislacionit mjedisor dhe hapësinorë;
- Mungesa e të dhënave dhe sistemit të informimit për menaxhimin e hapësirave publike etj.

Sektori i mirëmbajtjes së hapësirave ka një karakter publik dhe duhet zbatuar në përpikmëri të gjitha ligjet, rregulloret, apo kornizën ligjore e cila rregullon këtë sektor të rëndësishëm për

çdo qytetar. Ky plan duhet të mundësoj komunës së Ferizajt, që të hartojë një dokument bazik i cili në të ardhmen do të jetë strategji veprimi për mirë menaxhimin e të gjitha hapësirave publike të cilat do të trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse duke gjetur zgjedhje racionale dhe funksionale. Nga njëra anë do të krijojë të ardhura shtesë për kompaninë, ndërsa në anën tjetër do të zvogëloj hapësirat të cilat deri më tani janë pa mirëmbajtje.

Komuna e Ferizajt është ndër komunat e para në Kosovë që ka përgatit një plan të tillë i cili do të shënojë kthesë pozitive dhe mund të shërbejë si shembull për komuna të tjera, se si duhet të mirëmbahen këto hapësira. Këto shërbime për qytetarët e Ferizajt janë duke u afuar përmes Ndërmarrjes Publike Lokale "AMBIENTI" Sh.A- Ferizaj.

Metodologjia

Në mënyrë që ky dokument të përgatitet sa më mirë dhe profesionalisht, është filluar me krijimin e një baze të të dhënave dhe sigurimin e njohurive të përgjithshme për parkingjet, hapësirat e gjelbërta, varrezat, sipërfaqet etj, trajtimin aktual të tyre si dhe për strukturën e sistemit aktual për menaxhimin e tyre.

- Hapi i parë gjatë përgatitjes së planit ishte mbledhja e të dhënave dhe informacionit;
- Hapi i dytë përshkrimi i gjendjes aktuale, duke e përfshirë identifikimin e fushave për përmirësim në hapësira;
- Hapi i tretë vlerësimi i performancës së sistemit aktual të menaxhimit të hapësirave.

Trajtimi i hapësirave:

Nga incizimi i realizuar në teren, mund të thuhet se ekziston një trajtim i mirëfilltë i hapësirave në komunën tonë.

Trajtimi i hapësirave publike është një proces i ndërlikuar i cili ndikon ndjeshëm në uljen e hapësirave të pashfrytëzuara dhe në mirëmenaxhimin e hapësirave në shfrytëzim. Deri më tani nuk ka ndonjë dokument i cili qartësisht do të merrej me trajtimin e hapësirave publike dhe do të shërbente si platformë për mirë menaxhimin e tyre dhe standartin të cilin duhet ndjekur në proceset integruese nëpër të cilat po kalon shoqëria.

Planifikimi operativ dhe planifikimi financiar

Ky seksion paraqet një analizë të ofrimit, të shërbimeve, të menaxhimit të hapësirave në Komunën e Ferizajt. Për parashikimet e përformancës financiare janë përdorur si bazë tarifatat ekzistuese, për të analizuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të ndërmarrjes. Është vendosur që çmimet për shërbimet e menaxhimit të hapësirave në komunë, të cilat do të ofrohen të jenë çmime të pranueshme të tregut.

Kostoja e ofrimit të shërbimeve për menaxhimin e hapësirave publike përbëhet nga kostot operative dhe kostot e çdo investimi potencial që kërkohet për ofrimin e një shërbimi të tillë. Pasi që ndërmarrja publike do t'i ofrojë shërbimet, nuk është supozuar ndonjë marzhë profiti. Megjithatë, të hyrat e gjeneruara duhet t'i mbulojnë kostot operative. Ky raport synon të ofrojë udhëheqje për nivelin e tarifave të nevojshme që duhet të arkëtohen në mënyrë që të mbulojnë kostot e ofrimit të shërbimeve.

Bazuar në të dhënat në dispozicion dhe në planin operativ të propozuar për menaxhimin e hapësirave publike, në vijim janë dhënë pikat kryesore të planit operativ të propozuar për: shërbimet e ofrimit për parkingje.

Planifikimi i Burimeve njerëzore (personeli)

Numri aktual i të punësuarve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, aktualisht është si në vijim:

NR	EMËRTIMI	NUMRI
1.	Komisioni Komunal i Aksionarëve	3
2.	Bordi i Drejtorëve	4
3.	Administrata	20
4.	Kontrollë	14
5.	Inkasant	32
6.	Hapësira të Gjellbërta	12
7.	Punonjës sezonal (hapësira të gjellbërta)	5
8.	TOTALI	90

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, varësisht prej vëllimit të punëve dhe sipas nevojës do të rritet numri i të punësuarve në ndërmarrje. Gjithashtu ndërmarrja sipas nevojës dhe vëllimit të punëve angazhon edhe punonjës sezonal, në vitin 2023 kanë qenë të angazhuar 5 punonjës sezonal.

Punonjës që do të pensionohen gjatë vitit 2024 është 1.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Në bazë të kërkesave të sektorëve do të bëhet një analizë e nevojave për trajnime dhe mbi këtë analizë do të hartohet plani i trajnimeve. Trajnimet duhet të jenë të fokusuara konform nevojave të stafit për njohuri të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së detyrave në ndërmarrje duke mbuluar trajnimet e demosdoshme për ngritje profesionale.

PLANIFIKIMI FINANCIAR PËR VITIN 2024

Pasqyra e të ardhurave për vitin 2024

1.	Të hyrat nga parkingjet publike	125,000.00€
2.	Të hyrat nga parkingjet e rezervuara	18,000.00€
3.	Të hyrat nga tregu i automjeteve	22,000.00 €
4.	Të hyrat nga parkingu nëntokësor	145,000.00 €
5.	Të hyrat nga tregu i kafshëve në Ferizaj dhe Dardani	25,000.00 €
6.	Të hyrat nga shërbimet ndaj komunës së Ferizajt	170,000.00 €
7.	Të hyrat nga qiraja e tregut të gjelbërt	30,610.00 €
	<u>Gjithësej të hyrat për vitin 2024 nga 1 deri 7</u>	<u>535,610.00 €</u>
1.	Shpenzimet e pagave	415,000.00 €
2.	Shpenzimet e kontributeve 5%	20,000.00 €
3.	Shpenzimet e telefonisë dhe internetit	1,900.00 €
4.	Shpenzimet e derivateve të naftës dhe vaj motorri	6,500.00 €
5.	Shpenzime të zyrës-mobilje karrika (inventar)	1,000.00 €
6.	Shpenzime për hapësira të gjelbërta	10,000.00 €
7.	Shpenzimet e provezionit banker	250.00 €
8.	Shpenzimet e sigurimi të zyreve	600.00 €
9.	Shpenzimet reprezentacionit	5,300.00 €
10.	Shpenzimet e byfësë dhe material higjenik	2,000.00 €
11.	Shpenzimet për blerjen e arkave	850.00 €
12.	Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve dhe mjeteve të punës	4,500.00 €
13.	Shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit të parkingut nëntokësor	4,800.00 €

14.	Shpenzimet për tiketa dhe material shpenzues	7,500.00 €
15.	Shpenzime për sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve	1,000.00 €
16.	Shpenzimet për zhvlerësimin të mjeteve	1,500.00 €
17.	Shpenzimet për blerjen e tiketave për parking nëntokësor (Garazhë)	6,500.00 €
18.	Shpenzimet për mirëmbajtjen e arkave	1,200.00 €
19.	Shpenzimet, matja e kënaqshmërisë së konsumatorëve	600.00 €
20.	Shpenzimet e auditimit të pasqyrave vjetore financiare (për 3 vite)	2,800.00 €
21.	Shpenzimet për marketing i punës ndërmarrjes (reklamim dhe sponsorizim)	600.00 €
	<u>GJITHËSEJ SHPENZIMET NGA 1 DERI 21 PËR VITIN 2024</u>	<u>494,400.00 €</u>
	<u>Fitimi bruto për vitin 2024</u>	<u>41,210.00 €</u>
	<u>Tatimi në fitim</u>	<u>4,121.00 €</u>
	<u>Fitimi apo humbja neto</u>	<u>37,089.00 €</u>

Ndryshimi në ekuitet 31.12.2024

Nr	Emërtimi i zërit	Nr.i shënimit	
			31.12.2024
1	Kapitali fillestar		10,000.00 €
2	Rezervat e kapitalit		
3	Fitimet e mbajtura ose humbjet e akumuluar		27,384.10 €
4	Fitimi ose humbja nga viti vijues		37,089.00€
5	Rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese të prekshme		
6	Rivlerësimi i pasurive jo qarkulluese të paprekshme		
7	Rivlerësimi i pasurive financiare në dispozicion për shitje		
8	Rivlerësime tjera		
Gjithësej kapitali dhe rezervat (1 deri 8)			64,473.10 €

Tabela:1

Në tabelën 1. janë të parapara ndryshimet në ekuitet sipas zërave, në të cilën janë përfshirë kapitali fillestar i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A, kur është themeluar ndërmarrja, fitimi i ndërmarrjes nga viti i kaluar dhe fitimi i ndërmarrjes i vitit vijues.

Përshkrimi i investimeve kapitale për vitin 2024

NR	Përshkrimi	Vlera
1	Kompjuter dhe paisje elektronike	2,000.00 €
2	Mobilje dhe inventar	1,000.00 €
3	Vegla të ndryshme për punë (operative)	10,000.00 €
4	Projekte me donator	20,000.00 €
5	Thithëse elektrike (e përdorur), për pastrimin e qytetit	12,000.00 €
6	Digjitalizimin e pagesave të parkingjeve	20,000.00 €
7	Cisternë për ujitje hapësirave të gjelbërta publike dhe larjen e rrugëve	20,000.00 €
	Totali:	85,000.00 €

Tabela: 2

Në tabelën 2. Investimet e planifikuara për vitin 2024, do të përmbushen nga fitimi i vitit 2023/2024, dhe nga donatorët potencial si: Komuna e Ferizajt, Fondet ndërkombëtare dhe vendore, Orgnaizata e ndryshme dhe nga Ministrinë gjegjëse etj.

Të gjitha investimet mund të rishikohen në varësi të situatës së krijuar si financiare dhe të tjera.

Shërbimet për parkingje

Në perspektivë mendohet edhe për parkingje të reja eventuale në bashkëpunim dhe kordinim me Komunën e Ferizajt.

- **Rrugët lokale të cilat mund të shfrytëzohen për parking të automjeteve janë:**

- Rruga "Dëshmorët e Kombit",
- Rruga "Ahmet Kaçiku",
- Rruga "Besim Rexhepi";
- Rruga "Vëllezërit Gërvalla";
- Rruga "Ramadan Rexhepi";
- Rruga "Tahir Sinani";
- Rruga "Hamëz Jashari";
- Të hyrat nga parkingu Rr. "Ahmet Kaçiku"; dhe
- Të hyrat nga parkingu nëntokësor në qytet.

Përmbledhje e shpenzimeve investive

Duke pasur parasysh se Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, parashihet të rritet në aspektin e ofrimit të shërbimeve, për t'i siguruar shërbimet, investimet fillestare në asetet fikse, janë të nevojshme si një kosto fillestare. Megjithatë, supozimet këtu janë ngritur mbi parimin se vendet, si ndërtesat (zyret e punës), do të sigurohen nga komuna në të ardhmen e afërt pa asnjë kosto nga ndërmarrja. Kështu që investimi është i nevojshëm vetëm për automjete, makineri dhe asete të tjera operative.

Investimet e lartëcekura mund të përmbushen edhe prej donacioneve apo rritjes së kapitalit aksionar nga Komuna e Ferizajt.

Qëndrueshmëria

Kur mendohet për qëndrueshmërinë e Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, për menaxhimin e parkingjeve, hapësirave publike dhe tregjeve periudha kohore e ekzistencës së kësaj ndërmarrje do të varet nga këta faktorë:

- Kërkesat e tregut;
- Operimi efikas;
- Kualiteti i shërbimeve;
- Teknologjia moderne;
- Digjitalizimi i shërbimeve;
- Tarifat e mundshme për shërbimet e ofruara, dhe
- Kursimi në shpenzime.